

STATUT I ORGANIZATËS JOFITIMPRURËSE

QENDRA

“INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE”

ISP-ALBANIA

(I miratuar me vendimin nr. 297, datë 27.03.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; i ndryshuar me vendimin nr. 297 /3, datë 07.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe i ndryshuar me vendimin nr. 297/6 datë 23.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)

Në Tiranë, sot më datën 27.03.2006, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil dhe në Ligjin 8788 të datës 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, në themeluesit e Institutit të Studimeve Politike përpilojmë dhe miratojmë statutin si më poshtë vijon:

Neni 1

Emri, forma dhe simbolet

Instituti i Studimeve Politike (ISP) është një organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar në formën e Qendrës.

ISP është person juridik pa anëtarësi, që ka për objekt të veprimtarisë së tij kryerjen e shërbimeve dhe realizimin e projekteve për qëllime në të mirë dhe në interes të publikut, me fonde dhe të ardhura të siguruara sipas ligjit.

ISP nuk lejohet si qendër të kryejë veprimtari fitimprurëse që nuk është në përputhje me ligjin.

Emri i shkurtuar i Institutit të Studimeve Politike është “ISP - Shqipëri” ose “ISP - Albania”.

Vula dhe simbole të veçanta të ISP i bashkëngjiten statutit pas momentit të regjistrimit në gjykatë.

Neni 2

Adresa e selisë

Selia e Organizatës është në Adresën: *Rruga "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89, K.3, Ap 16 A, Tiranë.*

Me vendim të Bordit të Drejtorëve, Qendra mund të hapë degë të saj dhe të emërojë përfaqësues edhe në qytete të tjera brenda edhe jashtë Shqipërisë.

Këto degë nuk janë persona juridikë të veçantë, por pjesë e organizatës që punojnë në emër dhe për llogari të saj.

Neni 3

Themeluesit

Themeluesit e Shoqatës janë:

- 1. Lutfi Dervishi, i biri i Isufit, i datëlindjes 22.9.1967, banues në Tiranë, pass. nr 0012895.*
- 2. Lazer Stani, i biri i Palit, i datëlindjes 17.1.1959, banues në Tiranë, pass. nr 00775744.*
- 3. Afrim Krasniqi, i biri i Lulashit, i datëlindjes 3.1.1973 banues në Tiranë, pass. nr 1012571.*

Neni 4 **Qëllimi i Organizatës**

Qëllimi i Qendrës, "Instituti i Studimeve Politike" është:

"Mbështetja dhe nxitja e transformimeve demokratike në Shqipëri në bazë të vlerave të demokracive perëndimore; nxitjen e kontakteve, shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës ndërmjet politikanëve, studentëve të shkencave politike, medias dhe studiuesve shqiptarë me ato të vendeve të tjera evropiane; nxitjen e integrimin euroatlantik të Shqipërisë, si dhe të çdo iniciative tjetër të ligjshme që ka në themel forcimin e parimeve demokratike të organizimit dhe funksionimit të institucioneve publike, në përputhje me aktet dhe standardet ndërkombëtare dhe respektimin e të drejtave të njeriut".

Bordi i Qendrës miraton programe të veçanta me natyrë strategjike që kanë për qëllim të caktojnë prioritete afatshkurta dhe afatmesme për zhvillimin e qëllimeve të aktiviteteve të Qendrës.

Neni 5 **Fusha e veprimtarisë**

Fusha e veprimtarisë së qendrës "Instituti i Studimeve Politike", përfshin përgjithësisht, çdo aktivitet të ligjshëm që ka lidhje me arritjen e qëllimit. Fusha e veprimtarisë në veçanti është që;

1. Të organizojë, hartojë dhe zbatojë projekte, kurse, konferenca, seminare, botime, tryeza debate me pjesëmarrjen e politikanëve, figurave publike, studentëve dhe ekspertëve të fushave të ndryshme;
2. Të nxisë edukimin dhe arsimimin politik, përmes organizimit të botimeve, trajnimeve dhe debateve politike;
3. Të zhvillojë leksione dhe diskutime sidomos në radhët e studentëve dhe të zgjedhurve qendrore dhe lokalë;
4. Të zhvillojë dhe zbatojë projekte në fushën publike për forcimin e vlerave demokratike të institucioneve, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe përmirësimit të aktivitetit të organeve shtetërore, sipas legjislacionit vendas dhe atij ndërkombëtar të ratifikuar me ligj.
5. Të bashkëpunojë me institute dhe organizata të tjera shqiptare dhe të huaja brenda dhe jashtë vendit për rritjen shkëmbimeve dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta;
6. Të krijojë një qendër dokumentacioni për ruajtjen e përpunimin e studimeve dhe të dhënave të evidentuara nga instituti.
7. Të ndjekë çdo rrugë ligjore për përmbushjen e qëllimeve të institutit.
8. Të pajiset me numër ISBN nga Agjencia Kombëtare e ISBN pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë me qëllim realizimin e botimeve e materialeve profesionale, libra dhe studime me ISBN, në përputhje me nenin 28 të ligjit nr. 9616, datë 27.09.2016 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë".

Neni 6 **Sigurimi i burimeve financiare dhe asetëve;**

Në veprimtarinë e saj Qendra do të ketë asete të qëndrueshme si kompjuterë, printerë, aparat telefoni, fotokopje, faks dhe kancelari, si dhe çdo pajisje apo ambient, të cilat do të shfrytëzohen nga themeluesit dhe personeli i Qendrës për të përmbushur qëllimin e Institutit të Studimeve Politike. Më tej në kryerjen e aktiviteteve të saj, Qendra mund të përdorë edhe mjete të tjera të ligjshme si, ndihma dhe grante të ndryshme

qeveritare dhe joqeveritare, dhurata dhe çdo ndihmë apo burim të ligjshëm financiar të vëna në dispozicion nga donatorë, kontraktorë apo nënkontraktorë.

Qendra në veprimtarinë e saj mund të krijojë dhe të ardhura financiare. Të ardhurat e qendrës mund të sigurohen nga:

- Kontributet e themeluesve.
- Aktivitete trajnuese dhe edukuese.
- Të ardhura dhe financime nga donatorët, vendas ose të huaj.
- Buxheti i Qendrës do të përbëhet edhe nga të dhuratat, ndihmat, programet e financuara nga organizmat ndërkombëtarë, fondacionet e huaja dhe kombëtare, bordet lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Të ardhura të siguruara nga vet veprimtaria e Qendrës.

Bordi i Qendrës miraton rregullore të veçantë për administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve financiare të aseteve dhe likuiditeteve, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Në çdo rast do të bëhet evidentimi i këtyre mjeteve financiare dhe do të hartohet dokumentacioni përkatës sipas ligjeve në fuqi.

Neni 7

Kontributi themeltar i Qendrës

Kontributi themeltar i themeluesve është një shumë prej 120.000 (njëqind e njëzet mijë) lekësh të depozituara në emër dhe për llogari të Qendrës, shumë kjo, e cila kalon në pronësi ekskluzive të Qendrës nga moment i regjistrimit të Qendrës, në Gjykatën e Shkallës Parë Tiranë.

Themeluesit kanë kontribuar secili nga 40.000 lekë dhe zhvishen nga e drejta e pronësisë së kësaj shume në momentin e përcaktuar më lart.

Neni 8

Ndalimi i shpërndarjes së fitimit

“Instituti i Studimeve Politike” si qendër, organizatë jofitimprurëse, nuk mund t’ia shpërndajë të ardhurat apo fitimet asnjë personi. Asetet, të ardhurat apo fitimet duhet të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës dhe nuk përdoren për të siguruar përfitime materiale-pasurore, direkt apo indirekt për asnjë nga themeluesit, drejtorin, zyrtarët, të punësuarit apo donatorët e Qendrës. Ky seksion përjashton pagesën e arsyeshme për personat që punojnë për organizatën në kuadër të kontratave të punës apo të angazhimit për veprimtari të caktuar.

Neni 9

Kohëzgjatja

Themeluesit e kanë krijuar Qendrën për një kohë të pacaktuar.

Neni 10

Organet drejtuese dhe struktura qeverisëse

Instituti i Studimeve Politike ka si organ të saj drejtues dhe vendimmarrës “Bordin e Drejtorëve”. Bordi i drejtorëve ka në përbërje të tij:

1. Drejtorin Ekzekutiv, si dhe komitetet si më poshtë vijojnë:
 - Komiteti i Kontrollit Financiar, i arkivave
 - Komiteti i Programit, i trajnimeve, i politikave me të tretët.

Neni 11
Organi më i lartë vendimmarrës
Bordi i drejtorëve

Organi më i lartë është vendimmarrës se qendrës është Bordi i Drejtorëve.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët emërohen nga themeluesit e qendrës për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Mandati i anëtarit të Bordit të Drejtorëve mund të mbarojë edhe më përpara afatit për shkak të largimit nga detyra nga organi i emërtesës ose edhe vullnetit të tij.

Neni 12
Kompetencat e organit më të lartë vendimmarrës

Bordi i Drejtorëve përveç çështjeve të cilat ai çmon se duhen të shqyrtohen prej tij dhe kanë lidhje me qendrën , vendos edhe për:

- Ndryshimin e Statutit,
- Harton politikat e brendshme dhe të jashtme për veprimtarinë e Qendrës,
- Përcakton fushat dhe programin e veprimtarisë,
- Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e veprimtarisë,
- Shqyrton çështjet ekonomike financiare dhe të administrimit,
- Nxjerrë norma dhe akte për rregullimin veprimtarisë, organizimit dhe strukturës,
- Zgjedh dhe emëron anëtarët e organit më të lartë ekzekutiv,
- Krijon komitete të posaçme, si edhe për çështje të tjera të parashikuara në ligj ose në statut,
- Vendos për bashkimin, ndarjen apo shpërndarjen e Qendrës.

Neni 13
Rregullat për mbajtjen e mbledhjes dhe marrjen e vendimeve të Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve mbledhet nga Drejtori Ekzekutiv si rregull 2 herë në vit. Bordi i Drejtorëve të Qendrës mbledhet edhe në ndonjë rast kërkesë të motivuar dhe të firmosur të paktën 1/3 (një të tretat) e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Mbledhja e parë zhvillohet në dhjetëditëshin e dytë të Janarit dhe e dyta dhjetëditëshin e dytë të Shtatorit. Secili prej anëtarëve të Qendrës njoftohet të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhje nëpërmjet një komunikimi me shkrim. Ky komunikim duhet të përmbajë vendin, ditën si dhe rendin e ditës që do të ketë mbledhja.

Mbledhja vazhdon punimet kur në të marrin pjesë 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve të bordit të Drejtorëve. Në rast se kjo pjesëmarrje nuk sigurohet njoftimi përsëritet dy herë. Në rast se edhe pas herës së dytë nuk është arritur numri i nevojshëm për të vazhduar mbledhjen, në herën e tretë mbledhja zhvillohet vetëm në qoftë se merr pjesë 1/3 e anëtarëve të Bordit të drejtorëve. Bordi miraton rregullore të veçantë për organizimin dhe funksionimin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Vendimmarrja e Bordit të Drejtorëve. Vendimet e Bordit të Drejtorëve në lidhje me veprimtarinë dhe çështje të tjera të qendrës merren me shumicën e thjeshte e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Në rast barazimi vota e drejtorit të bordit është përcaktuese. Vendimet për ndryshimin e Statutit, të Aktit të Themelimit për miratimin e rregulloreve të brendshme, merren me 2/3 e votave.

Vendimi i mbledhjeve. Bordi i Drejtorëve mund të mbledhet në selinë e saj qendrore në Tiranë. Në raste të veçanta ai mund të mbledhet edhe jashtë kësaj selie, në çdo vend të caktuar nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 14

Organi më i lartë ekzekutiv

Organi më i lartë ekzekutiv është Drejtori Ekzekutiv. Drejtori ekzekutiv zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve për një mandat 4 (katër) vjeçar me të drejtë rimandatimi. Ai ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

Neni 15

Kompetencat e organit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij ka këto kompetenca:

- Planifikon veprimtarinë vjetore 6/mujore të Qendrës dhe ia paraqet për miratim Bordit të Drejtorëve;
- Planifikon projekt-buxhetin dhe ia paraqet për miratim Bordit të Drejtorëve;
- Kujdeset dhe organizon zhvillimin normal të mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve;
- Realizon veprimtarinë e përditshme dhe ekzekuton programet e vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës;
- Drejton veprimtarinë administrative e Qendrës në bazë të Statutit;
- Administron fondet sipas mënyrës së caktuar nga Bordi i Drejtorëve dhe aktet në fuqi;
- Hyn në marrëdhënie dhe përfaqëson qëndron me të tretët, me organizma të tjera vendase dhe të huaja.
- Propozon për vendimmarrje në Bordin e Drejtorëve projekt-akte, plane strategjike dhe rregullore të brendshme në përputhje me nevojat e Qendrës.
- Ka cilësinë e punëdhënësit dhe nënshkruesit të kontratave apo marrëveshjeve të tjera me të tretët për qëllimet e ligjshme të Qendrës.
- Ka në varësi institucionale dhe administrative të gjithë personelin ekzekutiv ndihmës dhe atyre të degëve lokale.
- Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste.
- Përfaqëson organizatën në marrëdhënie me subjektet, private ose publike, të tilla si donatorë, klientë furnizues apo subjekte të tjera private, si dhe me të gjitha nivelet e qeverisjes që rregullojnë veprimtarinë e organizatës.

Neni 16

Kriteret për administrimin e pasurisë

Asetet që janë dedikuar për të përmbushur qëllimin e Organizatës dhe kryerjen e aktiviteteve të saj dhe që përfshijnë, ndihma dhe grante të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, ndihma dhe burime të ligjshme financiare të vëna në dispozicion do të inventarizohen dhe menaxhohen nga organi administrativ, drejtori dhe financieri i Qendrës me fillimin e veprimtarisë së saj.

Kriteret specifike dhe rregulla më të hollësishme për investime mund të vendosen në mbledhjen e bordit të drejtorëve.

Neni 17

Rregullat për bashkimin dhe ndarjen e Qendrës

Qendra me vendim të Drejtorit Ekzekutiv dhe me miratimin dhënë në unanimitet të Bordit të Drejtorëve, për arsye të lehtësirave që mund të krijohen nga bashkimi gjithmonë në të mirë të arritjes së objektivit të Qendrës, mund të ndahet ose të bashkohet me organizata të tjera jofitimprurëse pa anëtarësi.

Qendra konsiderohet e shpërndarë me regjistrimin e subjektit të ri.

Neni 18

Përfaqësimi i qendrës në marrëdhënie me të tretët

Drejtori Ekzekutiv drejton dhe përfaqëson qendrën në raport me të tretët. Në mungesë të drejtorit ekzekutiv për një periudhë 1 (një) mujore, detyrën e tij e kryen anëtari më i vjetër në moshë, me autorizim të Drejtorit Ekzekutiv.

Në rastet kur përfaqësimi kryhet nga një anëtar i Bordit të Drejtorëve, veprimet e tij ratifikohen në mbledhjen më të parë.

Neni 19

Rregullat për likuidimin

Vendosja në likuidim e Qendrës, kur nuk vendoset nga një organ tjetër kompetent, përcaktohet nga Bordi i Drejtorëve, i cili kontrollon dhe miraton përfundimisht procedurat e likuidimit dhe mbylljen e Qendrës. Likuiduesit ose likuidatorët emërohen me vendim të Bordit të Drejtorëve. Vendimi për emërimin e likuiduesve dhe likuidatorëve merret me unanimitet. Likuidatori mund të caktohet edhe nga Gjykata. Me emërimin e likuidatorit ose likuidatorëve pushojnë funksionet e Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 20

Likuidatorët

Likuiduesi ose likuidatorët, brenda 2 (dy) muajve nga dita e emërimit, thërrasin Mbledhjen Bordit të Drejtorëve, ku paraqesin raportin mbi gjendjen financiare të Qendrës, aktivin dhe pasivin e Qendrës, para se të fillojë operacioni i likuidimit.

Likuiduesi dhe likuidatorët përfaqësojnë Qendrën dhe kanë të gjitha kompetencat e nevojshme për likuidimin e pasivit të saj. Janë të autorizuar të paguajnë të gjithë kreditorët dhe me pas të vlerësojnë të gjithë pasurinë e mbetur dhe kujdesen, që kjo pasuri të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga Statuti.

Neni 21

Rregullat për destinimin e pasurisë pas mbarimit të Qendrës

Të gjitha subjektet me të cilat "Instituti i Studimeve Politike" ka pasur projekte dhe programe të përbashkëta në mënyrë preferenciale u kalon 70 % e aktivitetit Pasuria e krijuar, pas shpërndarjes së saj.

Pjesa tjetër e pasurisë, 30 % e aktivitetit, pas shpërndarjes, do t'u kalojë në mënyrë proporcionale, të gjitha organizatave joqeveritare homologe, të cilat veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe kanë objekt të ngjashëm ose fusha veprimtarie të përbashkëta.

Neni 22

Marrëdhëniet me institucionet dhe punëmarrësit

Marrëdhëniet e punësimit brenda Qendrës rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në përputhje me ligjin Nr. 7961, dt. 12.07.1995 (kodi i punës), si dhe legjislacionit tjetër shqiptar që bën fjalë për punësimin.

Marrja në punë behet me regjistrimin nga punëdhënësi në librin e punës së shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e punës të juridiksionit ku ushtron veprimtarinë Qendra. Largimi nga puna bëhet me mbarimin e kontratës së punës, për shkelje disiplinore, ose me vetë kërkesën e të interesuarit. Largimi nga Qendra bëhet pasi janë shlyer të gjitha detyrimet materiale e monetare. Marrja në punë, ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në baze të një akti të lëshuar me shkrim nga Drejtori Ekzekutiv.

Qendra mund të lidhë kontrata me sektorë shtetërorë, drejtpërdrejt në tregun e lirë, si dhe me persona fizikë ose juridikë, vendase ose të huaj. Në veprimet kontraktuale brenda dhe jashtë vendit, shoqëria përfaqësohet nga drejtori ekzekutiv, ose nga një person tjetër i autorizuar prej tij me prokurë, e cila i njoftohet në raste të veçanta bordit të drejtorëve në mbledhjen më të afërt. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për Qendrën.

Bordi i Drejtorëve me propozim të Drejtorit Ekzekutiv miraton rregulloren e përgjithshme të Qendrës për caktimin e rregullave të brendshme të organizimit dhe funksionimit administrativ të të gjithë sektorëve dhe filialeve të Qendrës.

Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Ekzekutiv ka detyrimin të shmangin konfliktet e interesave ndërmjet vetë organizatës dhe anëtarit të organit vendimmarrës, ekzekutiv ose punonjësit të saj. Rastet e konflikteve dhe procedurat e zgjidhjes së tyre parashikohen nëpërmjet një rregullore të veçantë që miratohet nga Bordi në përputhje me ligjin.

Bordi i Drejtorëve me propozim të Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës miraton rregullore të veçantë mbi transparencën e veprimtarisë së Qendrës.

Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve, ndërmjet tyre dhe organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive ose ndërmjet tyre dhe të punësuarve zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me statutin dhe rregullat e Qendrës, në të kundërt çështja zgjidhet nga gjykata kompetente.

Dispozita transitore

Neni 23

Përbërja e organeve të para drejtuese

Bordi i Drejtorëve do të përbëhet nga:

- | | | |
|----|----------------------------------|----------------|
| 1. | Drejtori Ekzekutiv | Lutfi Dervishi |
| 2. | Komiteti i Kontrollit Financiar, | Afrim Krasniqi |
| 3. | Komiteti i Programit | Lazër Stani |

Nënshkruesit

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Lutfi Dervishi

Afrim Krasniqi

Lazër Stani